



Data: 03.02.2026



Në mbështetje të dispozitave të nenit 14 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me dispozitat e Rregullore për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal, me qëllim të lirimit të hapësirave publike dhe pronës komunale, nxjerr këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Komuna e Gjakovës do të ndërmarrë masa për lirimin e pronave komunale dhe hapësirave publike të cilat shfrytëzohen pa kontratë të vlefshme, duke përfshirë: objektet komunale, rrugët, trotualet, dhe sipërfaqet tjera publike. Prandaj, njoftohen qytetarët, subjektet afariste dhe shfrytëzuesit e pronës komunale që të aplikojnë për pajisjen me kontratë përkatëse nga Komuna e Gjakovës.

Në rast se shfrytëzuesit e pronave komunale nuk pajisen me kontratë për shfrytëzim, obligohen që të lirojnë pronat dhe hapësirat publike në të kundërtën Komuna e Gjakovës, respektivisht Drejtoria e Inspektoratit, do të ndërmerr masa ndëshkuese – gjobë sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe do të ushtrojë kallëzim penal në institucionet përkatëse, pas konstatimit për uzurpim.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

